

VEPRAT E ISMAIL KADARES SA ORIGJINALE PO AQ EDHE UNIVERSALE

Arbana AJDINI¹

^{1*} *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: arbana.ajdini@unite.edu.mk*

Përmbledhje

Ismail Kadare është një ndër personalitet më të shquara që i ka dhënë vlerë të lartë letërsisë moderne shqiptare, por edhe asaj botërore. Aftësia krijuese e tij është e jashtëzakonshme, pasi ka arritur që përmes mitit të eksplorojë tema nga bota shqiptare duke u dhënë atyre një dimension universal. Eksplorimi i jetës dhe hapsirave shqiptarë është përshkruar me një stil unik. Vepra e Ismail Kadares është cilësuar si universale, por në fakt rrënjët i ka të ngulitura thellë në traditën dhe historinë shqiptare.

Universi i krijimtarisë së tij vërehet me galerinë gjigante e të pafundme të personazheve që parakalojnë në romane, ku përmes tyre sjell tragjizmin e botës shqiptare ndër shekuj, duke sjellur një vezullim magjik në letërsinë shqiptare. Me një mjeshtëri artistike Ismail Kadare prozës moderne shqipe i dha një ndriçim shumë ngjyrshëm, duke flakur metodat dhe strukturat e vjetra të mendimit, si dhe format e ligjëritimit. Në letërsinë shqipe ka sjell një dimension të ri në mënyrën e mendimit filozofik, sa që i gjithë opusi letrar i tij të shfaqet sa origjinal po ashtu edhe universal.

***Fjalët kyçe:** universalja, vepra letrare, historia dhe kultura, tragjizmi, miti, mendimi filozofik.*

Ismail Kadare është një ndër shkrimtarët me një imagjinatën të jashtëzakonshme, ku intuita, talenti si dhe mjeshtëria artistike kanë qenë pikat e referimit në të cilat është mbështetur vet shkrimtari, që padyshim janë të thella, ku përmes pendës arriti që të lexuesi shqiptar dhe i huaj të përcjell krijimet artistike të krijuara nga një shpirt i trazuar, ku përmes imagjinatës së trillit ka arritur të shfaq botën shqiptare tek personazhet. Leximi i romaneve të Ismail Kadares është një sfidë, pasi ata kërkojnë thellësinë e mendimit, për të zbërthyer idetë e paraqitura nga vet shkrimtari, pasi romanet e tij janë të krijuara nga tragjikja e botës shqiptare.

Veprat e Ismail Kadares janë rrëfime të pashtershme të jetës shqiptare dhe ballkanike në përgjithësi. Ato tregojnë për historinë, kulturën dhe shoqërinë shqiptare në periudhën e komunizmit dhe pas saj. Proza e tij në vazhdimësi ka evoluar, duke sjell rezultat në transformimin e kuptimit, figurave, njehërit duke ndryshuar trajtat e diskuseve, duke e bërë të mundur krijimin e nëntekstit për të kuptuar shfaqjen e mendimit historik, shoqëror dhe psikologjik. Ismail Kadare është një ndër shkrimtarët i cili në veprat e tij shpreh mendimet dhe ide të thella mbi njerëzimin, historinë, kulturën. Me mjeshtërinë artistike ka arritur të krijoj karaktere të rrënjësura thellësisht në kontekstin historik dhe për të shprehur dilemat morale dhe etike që njerëzit përballen nëpër shekuj. Veprat e Ismail Kadares janë vlerësuar për lirinë e tyre artistike dhe për aftësinë e tyre për të evokuar emocione dhe reflektim. Ato janë një kombinim i shkëlqyeshëm i historisë dhe fiksonit, të cilat i japin atyre një vlerë filozofike dhe prekëse.

Kjo i bën ato të jenë universale, duke i dhënë audiencës së gjërë mundësinë për të reflektuar mbi temat dhe dilemat universale të njërëzimit. Gjithashtu veprat e tij janë të njohura për mënyrën se si ai përdor historinë dhe mitet për të eksploruar temat e dëshirës për liri, trysninë politike, dhe konfliktet shoqërore. Në romane Kadare na shfaqet jo vetëm si një zë i fuqishëm për kulturën dhe historinë shqiptare, por edhe si një zë universal që përfaqëson humanizmin dhe shpirtin njerëzor. Vlerësimi dhe gjykimi për një vepër nuk është e lehtë, andaj sipas disa mendimeve „gjykimi mbi një vepër letrare s’ mund të jetë thjeshtë dhe vetëm produkt i derdhjes së përshtypjeve personale, thellësisht subjektive, të paargumentuara shkencërisht e të dhëna vetëm në formë supozimesh, sepse në këtë rast do të dukej se më e rëndësishme është mënyra subjektive e përjetimit të veprës nga kritiku, ndërsa vështrimi rreth specifikave letrare të veprës do të lihej mënjanë.

Një gjykim i mbështetur në njohjen e poetikës letrare, pra një formim teorik në kuptimin e veçorive që i takojnë brendisë artistike të veprës letrare është, pa diskutim, kërkesë e domosdoshme për kthesën që duhet të bëjë kritika e sotme letrare.”¹ Vlera artistike e romaneve është e jashtëzakonshme, mënyra e perceptimit se si është përqsaur temave historike e shoqërore, ngjarjeve, gjendja psikologjike e një galerie të tërë të personazheve, mundësuan shkëlqimin e prozës së tij, duke i dhënë vlerë, vlera të cilat e pasuruan letërsinë moderne shqiptare, duke e shpjerrë drejt letërsisë evropiane.

Mjeshtëria artistike e Ismail Kadares ishte shumë e lartë, duke arritur që përmes imagjinatës së trillit të vet të krijojë subjekte brilante në prozën e tij, duke sjell në vëmendjen e lexuesit të shkuarën dhe të tashmen përmes komunikimit të një galerie të madhe të personazheve që vijnë nga tradita shekullore e popullit shqiptar, duke paraqitur karakterin dhe vlerat njerëzore të njeriut. Mirëpo, universi poetik i Kadares shfaqet tek njeriu i cili ka trashëguar historinë ku nderi dhe besa janë ndër vlerat më të shenjta që populli shqiptar i ka ruajtur shekuj pas shekuj, duke i trashëguar brez pas brezi, vlera këto që në të shumtën e herës kanë marrë formën e mitit.

Përveç mitit, në romanet e tij na përshkruhet edhe kanuni, si në *Prilli i thyer*, rapsod me *Kush e solli Doruntinën?*, *Ura me tri harqe*, etj, në keto dhe shumë vepra të tjera, ka shfaqur kulturën dhe historinë shqiptare që i ka mbijetura sundimit shekullor, andaj shkrimtari me një mjeshtëri të lartë artistike duke përdorur imagjinatën, talentin i ka ringjallur këto legjenda në një formë të jashtëzakonshme, duke ua kthyer identitetin e vërtetë në letërsinë tonë moderne, anadaj lirisht mund të themi se Ismail Kadare është një mjeshtër i vërtet i trajtimit të mitit, pasi trajtimi i mitit veprës së tij i jep shpirt. Merita më e madhe e Kadaresë është se përmes shkrimeve të tij arriti të tregojë historinë e Shqipërisë, mitet dhe legjendat e saj që udhëtuan nëpër kohë e që morën identitetin e duhur në letërsinë moderne dhe postmoderne.

Kadare i shndërroi mitet në realitet dhe realitetin në mit. Duke i modernizuar mitet, autori tregon historinë e Shqipërisë, e cila gjindet në një udhëkryq e që sistemi totalitar nuk mundi të prishte folenë e miteve dhe legjendave. Ai nuk ngurroi të përdorte këto mite dhe legjenda për t’i shndërruar në simbole. U bë edhe vetë simbol. Simbol i Shqipërisë, sikurse Eskili, simbol i Greqisë. Dy mijë e pesëqind vjet më vonë, Kadare mori rrugën e mërgimit për të shkuar gjurmëve të Eskilit, për të vazhduar mitin e tij dhe në një mënyrë “të gjej te ai pishtarin e vet.”²

Karakteristikë e romaneve të tij është pasqyrimi dhe mënyra e shtjellimit të ngjarjeve nga e kaluara historike dhe aktulitet duke zbuluar se sa të thella janë veçoritë shpirtërore të popullit shqiptarë ku përmes mjeshtërisë artistike u ka dhënë atyre një zë universal, pasi ato trajtojnë dhe prekin tema në mënyrë të përsëritur nga përvojat njerëzore të kulturave të ndryshme.

¹ Floresha Dado, Intuitë dhe vetëdije kritike, Tiranë, 2006, f. 95.

² Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë Dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2012, f. 288.

Si shumë shkrimtarë të letërsisë botërore edhe Ismail Kadare inspirohet nga mitet, legjendat dhe baladat duke i vendosur personazhet e tij në dimensionin dhe kohën e sotme ku në tërësi shfaq një univers mitik të jashtëzakonshëm, duke krijuar vepra që me plot kuptim themi se janë monumentale dhe njëherit të përjetshme. Në shumë vepra të letërsisë gjakmarrja është lëvruar si temë kryesore e subjektit, mirëpo Ismail Kadare me një mjeshtëri artistike ka ditur më së miri ta përshkruaj gjakmarrjen, ku së bashku me rregullat e Kanunit ka shfaqur relitetin shqiptar në momentet e tij më të vështira. Në romanin *Prilli i thyer*, më së miri shfaqet realiteti shqiptar që është prezent edhe në ditët tona, ku gjakmarrja dhe besa janë prezente, përshkrimi i të cilave bëhen në një mënyrë aq origjinale duke i sjell lexuesit vetëdijen e njeriut që edhe sot e kësaj dite vazhdon të dominohet nga vlerat e së kaluarës.

Në *Prillin e thyer*, Kadare ka dashur të tregojë fenomenin tragjik të gjakmarrjes, një univers i Atridëve në ditët e sotme. Ai e gjen mënyrën letrare të inspirimit tek Eskili, mirëpo, realiteti i jetës së përditshme ishte një bashkëdyzim që dha romanin me ndjenja nga më tragjike. Këtë më së miri e afirmon E. Faye, i cili thotë se Kadare ka vendosur në *Prillin e thyer* ndjenën tragjike dhe frymëmarrjen që ngjall Orestin. Fati i personave në gjakmarrje është se ndjena e tyre nuk i lë të qetë në asnjë çast, ata mund të reagojnë në çdo kohë, në çdo vend vetëm që të kryejnë detyrën që e kanë obligim.³

Në botën shqiptare gjakmarrja është shfaqur gjithmonë si një vlerë e patjetërsueshme e cila vjen si rezultat i ruajtjes së nderit ndër familjet shqiptare, pra si një obligim apo detyrë që në fakt është imponuar nga ligji apo normat kanunore, ku jeta e të gjallëve dhe e të vdekurve është e lidhur me njëra tjetrën. Bota krijuese e shkrimtarit është aq imagjinare sa që ka arritur që edhe peronazhet e tij ti krijoj nga miti, të cilët në fakt po jetojnë në një botë që është e lidhur me mitologjinë moderne, por në realitet parqet jetën reale të shoqërisë, për të treguar se shqiptarët mbështeten edhe sot e kësaj dite në ligjet dhe normat e Kanunit për të pastruar nderin e familje, që në këtë kohë është një absurditet i theksuar, por një gjë është e pashmangëshme së gjaku në fakt jep jetën mirëpo edhe ta merr jetën.

Një nga veçoritë e gjakmarrjes është se mund të shpërthejë në çdo moment në një shpirt, qoftë në atë të një njeriu të dashur dhe të qetë sado pak, që një ofendim i rëndë ka ardhur të zgjojë në te nevojën shekullore të bëjë drejtësi për vete.⁴ Krijimtaria artistike e Ismail Kades është e ndërthurur me të kaluarën dhe me realitetin me të cilin jeton shoqëria shqiptare, andaj në shkrimet e tij gjithnjë janë përfshirë miti në dimensione të ndryshme por edhe legjendat. Në romanin *Ura me tri harqe*, shkrimtari bën përshkrimin se si mitizohet ura në legjendë, ku në fakt bëhet murrosja e njeriut. Imagjinata e thellë e këtij krijues arriti që të shpalos përmes mitit historinë dhe kulturën e trashëguar të popullit shqiptar.

Gjithpërfshirja e besës te Shqiptarët ka krijuar një mit të vërtetë. Madje edhe në botën e të vdekurve, miti i besës ka një kuptim sublim. Shembulli më i mirë i kësaj bese është te legjenda Konstantini dhe Doruntina, e njohur edhe me tituj të tjerë si Fjala e dhënë, Udhëtimi i vëllaut të vdekur, Kalërimi i të vdekurit. Këtu besa shqiptare mbretëron në mendjen e secilit duke transmetuar kulturën e pasur të legjendave që arritën të mbijetojnë deri në ditët e sotme. Legjenda Konstantini dhe Doruntina përmban elementin e besës që lidh jetën me vdekjen: „forcë sublime, e aftë të forcoj ligjet e vdekjes.”⁵ Historikisht në botën shqiptare besa ka qenë një vlerë e madhe e cila nuk duhet që të shkelej për asnjë arsye, që në realitetin shqiptar kishte një fuqi që i tejkalonte të gjitha vështësitë.

³ Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë Dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2012, f. 289.

⁴ Valbona Gashi, Perspectives comparatistes à partir de l'œuvre de S. Frasheri, A.N.R.T., Lille, 2000, f. 213.

⁵ Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë Dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2012, 292.

Në jetën e popullit shqiptarë besa ka qenë e pranishme në çdo kohë dhe hapsirë. Duke përdorur mitin Kadare ka arritur që të lexuesi të përcjellë mitizimin e ngjarjeve që tek shqiptarët kanë qenë të shumta, andaj me intelektin e tij ka arritur që të shpalos identitetin shqiptar ashtu siç është në realitet, e gjithë kjo i ka shërbyer shkrimtarit si një thesar i çmuar që ka ndikuar në krijimin e veprave me vlerë të lartë artistike. Aftësia krijuese e këtij shkrimtari i tejkalon pritshmëritë e lexuesit, për arsye se me taletin, intuitë, ka arritur të krijojë vepra madhështore, duke i dhënë letërsisë shqiptare vlerë të jashtëzakonshme, duke e rradhitur përkrah letërsisë botërore. Shkrimtari Ismail Kadare shkeljen e besës në vepër *Kush e sollli Doruntinën?*, na e paraqet të varrosur nën dhe, bashkë me besën edhe Konstantini ishte i varrosur, duke e shtuar dhimbjen njerëzore, ku ndër të tjera shprehet:

*Konstantin, të ardhhtë gjëma,
Ku e ke besën që më dhe,
Besa jote nën dhe.⁶*

Trajtimi i mitit e bën prozën e tij të dallohet për nga përmbajtja e thellë në aspektin filozofik, gjë që ka ndikuar në stilin e tij duke e bërë atë të veçantë në letërsinë moderne shqiptare por edhe botërore, që ndikoi tek lexuesi në shfaqjen e një kuptimi sa më të thellë për historinë dhe kulturën shqiptare. Në shumë romane miti na shfaqet sa misterioz po aq edhe mistik, që në të njëjtën kohë hap mundësinë e një rruge të dytë alternative për interpretim, ku e kaluara është e pranishme por ndikimi i saj vazhdon të gjykohet edhe në kohën e sotme moderne. Universaliteti në veprat e tij është i tejskajshëm për arsye të trajtimit të temave të shumta të marra nga sistemi diktatorial që ka qenë i pranishëm në shoqërinë shqiptare, ku kthetrat e politikës kanë qenë prezente gjatë gjithë kohës.

Aspekte të shumta kanë ndikuar që veprat e Ismail Kadares të jenë universale, përdorimi i gjuhës, stili i tij i veçantë ka ndikuar që veprat të kenë një përshkrim të theksuar të dialogjeve dhe mologjeve të personazheve që kanë ndikuar në trasmetimin sa më origjinal të ngjarjeve të botës shqiptare në tërësi. Përshkrimi i ngjarjeve, përfytyrimet e shumta, ambienti dhe temat, personazhet, janë sjellë me një origjinalitet të theksuar. Mënyra e realizimit të romaneve të Ismail Kadares kërkon një shtjellim dhe analizë të theksuar, me qëllim të nxjerrjes në pah të bërthamës së rrëfimeve artistike. Andaj, i gjithë opusi i krijimtarisë letrare i Kadares është vlerësuar si universal.

Referencat

- [1]. Dado, Floresha, (2006) Intuitë dhe vetëdije kritike, Tiranë.
- [2]. Gashi, Valbona (2000), Perspectives comparatistes à partir de l'œuvre de S. Frasheri,
- [3]. A.N.R.T., Lille.
- [4]. Kadare, Ismail (2004), *Kush e sollli Doruntinën?*, Onufri, Tiranë.
- [5]. Pipa, Arshi, (1941) Për një kritikë letrare, Shkëndija 2,3 Tiranë
- [6]. Sinani, Shaban. (2009). Për prozën e Kadaresë. Tiranë: Naimi.
- [7]. Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë Dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2012,

⁶ Ismail Kadare, *Kush e sollli Doruntinën?*, Onufri, Tiranë, 2004 f. 64.